

# AKT THEMELIMI

## "ProBrands" SHPK

### 1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë

Emri i shoqërisë do të jetë ProBrands sh.p.k, nga këtu e më poshtë referuar edhe si "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

### 2. Ortaku i shoqërisë

Ortaku i vetëm i shoqërisë është:

Z., **Johan Angjeli** i datëlindjes 06.01.1995, banues në Tiranë, i identifikuar nga karta e identitetit me nr. Personal J50106075V, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

### 3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- Të importojë makina profesionale për përgatitjen e kafesë nga furnizues ndërkombëtarë, duke siguruar cilësi të lartë dhe teknologji të avancuar.
- Të shpërndajë dhe shesë me shumicë dhe pakicë pajisjet profesionale për kafe në tregun vendas, duke u fokusuar në klientë komercialë si zyra, hotele, restorante dhe kafene.
- Të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes dhe riparimit për pajisjet e importuara, duke siguruar funksionimin e tyre të pandërprerë dhe në gjendje optimale.


Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Administratorit.

### 4. Selia e shoqërisë

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: "Rruga Ismail Qemali, Pallati 27/1, Apartamenti 2"
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

### 5. Kohëzgjatja e shoqërisë



- Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i **pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**6. Kapitali themeltar**

- Kapitali themeltar i shoqërisë është : 10 000 ALL.

**7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë**

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Administratori.

**8. Administratori**

- Administrator i parë i shoqërisë është: **z. Johan Angjeli.**

**9. Likuidimi i shoqërisë**

Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

**Date 26.05.2024**

**ORTAKË TË SHOQËRISË**

**Johan Angjeli**

